



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 08.04.2019, ora 13:00

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – nënkryetare e komisionit

Rendi i ditës:

Vizitë pune e Komisionit në Universitetin e Sporteve.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Ismet Beqiraj, Adelina Rista, Fadil Nasufi, Mirela Kumbaro, Lindita Nikolla, Almira Xhembulla, Aurel Xhindi (deputet zëvendësues).

Mungojnë:

Vilma Bello, Musa Ulqini, Bujar Çela.

Prezent:

Agron Cuka – Rektor i Universitetit të Sporteve,

Robert Çitozi – zëvendësrektor për anën mësimore i Universitetit të Sporteve,

Juel Jarani – zëvendësrektor për anën shkencore i Universitetit të Sporteve,

Mirlinda Galushi – administratore e Universitetit të Sporteve.

HAPET MBLEDHJA

(Diskutime në sallë.)

Agron Cuka – ...Universiteti ynë hynte në rangun e shkollave universitare. Kështu trajtohej dhe kështu ka qenë deri në vitin 2000, kur u bë akademi me program katërvjeçar. Pastaj, me ndryshimet e reja në vitin 2010, që ndodhën në hartimin e programeve në kuadrin e Kartës së Bolonjës, u bë universitet.

Ne kemi një program pesëvjeçar për përgatitjen e mësuesve: *bachelor*, tre vjet, plus master, dy vjet, ndërkohë që në fakultetin e dytë kemi programin 3+1. Fakultetet janë: Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes, që kryesisht përgatit mësues të edukimit fizik, por kemi pasur edhe një program për përgatitjen e trajnerëve, që nuk i rezistoi kohës, pasi me ndryshimet e bëra, federatat kanë kompetencat e tyre për përgatitjen e trajnerëve me kurse të ndryshme. Ne po ngulim këmbë që të kemi bashkëpunim me ta, të vijmë t'i bëjmë me ne, sepse këtu ka kuadro që merren me shkencat sportive dhe mund të japin kontributin e tyre. Por deri tani ka pasur disa vështirësi në këtë aspekt.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Si program nuk ka ecur dhe është mbyllur.

Fakulteti i dytë është Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, ku përgatiten specialistë ose trajnerë të fitnessit, që punojnë nëpër palestra ose bëjnë stërvitje individuale me persona të ndryshëm. Aty marrin edhe njohuri për sportin e aventurës...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

...Ose, më saktë, për turizmin e aventurës, pra mësojnë sportet dimërore, sportet ujore, si: zhytje, kajakë, kanoe; mësojnë not, marrin njohuri për ndihmën e shpejtë e të tjera, plus edhe sportet verore që janë: ngjitjet, *hiking*, sporte malore, siç i quajmë ndryshe. Pra, nuk është thjesht përgatitje e specialistëve që të çojnë në një muze dhe të tregojnë se çfarë ka aty brenda, por kanë të bëjnë edhe me disiplina të trendit të sotëm shqiptar.

Faktikisht, nga të dhënat që dimë, shumë persona vijnë gjatë verës dhe ne jemi fokusuar te plazhi, por shumë të tjerë vijnë edhe për turizmin malor.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Shqipërinë e pëlqejnë shumë për strukturën që ka si vend, sa i mbledhur është dhe sa afër i ka gjërat: do të shkosh në det, do të shkosh në mal a gjetkë, ata vijnë me shumë dëshirë.

Siç edhe ju, në fakt, keni deklaruar...pritet që këtë vit të ketë rreth 10 milionë turistë, nga të cilët, sigurisht, shumë janë nga këta që shohim me biçikleta e të tjera me radhë, por do të jenë pikërisht studentët tanë, që marrin këto diploma, të cilët do t'i shoqërojnë.

Gjithashtu, kemi një Institut për Kërkimin Shkencor, i cili ka dy departamente: njëri merret me sportin cilësor, kurse tjetri merret me sportin masiv, po themi, me aktivitetet e lira, me shëndetin e popullatës e kështu me radhë.

Kemi nisur dokumentacionin dhe kemi bërë të gjithë punën e domosdoshme për të hapur një fakultet të tretë, siç kërkohet sipas ligjit, ku çdo universitet duhet të ketë tri fakultete dhe kemi menduar që ky të jetë fakulteti i Rehabilitimit, i cili përfshin në vetvete edhe fizioterapinë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kemi menduar rehabilitimin, sepse bazohet te veprimtaria lëvizore, të cilën e kemi bazë. Sigurisht, është studiuar edhe tregu, ku shumë nga ish-studentët tanë punojnë nëpër spitale, i kemi vërejtur dhe konstatuar, si dhe kemi eksperiencë botërore, që ky është një trend shumë i rëndësishëm sot, se janë pikërisht këta njerëzit që njohin edhe aktivitetin lëvizor dhe punojnë tani në riaftësimin e njerëzve.

Kjo është gjendja në universitetin tonë.

Kemi rreth 1400 studentë, i mbulojmë të tria nivelet e diplomave: *bachelor*, master profesional dhe master shkencor, si dhe doktoraturën.

Aktualisht kemi një rënie të konsiderueshme të numrit të profesorëve dhe jemi në vështirësi. Presim të dalin udhëzime të reja. Është thënë që universiteti ynë, Universiteti i Arteve dhe Ushtria mund të marrim një status të veçantë. Ndaj, mbi bazën e kësaj, do të kemi mundësi pastaj të japim edhe tituj shkencorë, sepse na është reduktuar shumë numri i profesorëve, pasi dihet që profesorët kanë moshë relativisht të madhe.

Ndoshta për vitin e ardhshëm, se na ikin edhe tre tani, na ngelen vetëm nëntë profesorë, flas profesor/doktor.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Sepse mbi bazën e tyre kryhet edhe veprimtaria e dhënies së titujve.

Jemi në pritje të tratativave me ministrinë. Të shohim si do të ecim më tutje.

Milva Ekonomi – Po bashkëpunime me shoqatat sportive ose turistike keni? Kam përshtypjen se *rafting* ka dalë më shumë nga nevoja e tregut dhe është rritur goxha sesa nga kërkesa juaj.

Agron Cuka – Me ta kemi një aktmarrëveshje, pikërisht që ata mund të marrin specialistë nga ne. Më duket se nga ne i kanë marrë nja pesë veta. Vitin e kaluar ishim në një panair botëror, që u mbajt në Berlin dhe patëm rastin të kontaktojmë edhe me shumë nga shoqatat tona, aq më tepër pastaj, kur u bë një panair tjetër, që e organizuat ju, mos gaboj...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, tek “Expo City”, ku, gjithashtu, ata u ndien mire, kur ne u folëm për fakultetin e dytë, atë të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, se ka njerëz të përgatitur në këtë fushë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Te ky fakultet kemi edhe një master profesional në degën “Menaxhim sporti dhe turizëm”, ku ka kërkesa të mëdha në fushën e turizmit, sepse janë pikërisht menaxherët, që do të merren edhe me turizmin ose nëpër klube sportive, ashtu siç kërkohen te firmat e ndërtimit që të ketë inxhinierë ndërtimi, pra edhe këtu te klubet tona kërkohen menaxherë, drejtues që janë diplomuar në këto degë.

Lindita Nikolla – A mund të na thoni diçka për akreditimin deri tani?

Agron Cuka – Ne i kemi realizuar. Grupi i anglezëve që erdhi këtu na dha një akreditim si institucion për tre vjet, për rrjedhojë ne i kemi dërguar të gjitha programet për t’i akredituar. Vetëm programi i masterit që ju përmenda: menaxhim sporti dhe turizmi, është i akredituar nga të gjitha programet e universiteteve në Shqipëri. Ky është programi i parë që është akredituar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, publik.

Tani kemi dërguar të gjitha programet e tjera, kemi zënë radhën që në dhjetor, këto ditë do të bëhet pagesa; kemi shkëmbyer shkresat dhe na kanë caktuar tarifën se çfarë duhet të paguajmë. Pra, kjo është situata: materialet janë gati, janë dërguar, do të bëhen edhe pagesat dhe ata do të kryejnë punën.

Robert Çitozi – Edhe detyrat që na lanë britanikë për gjashtë muaj, i rregulluam të gjitha, në mënyrë që dokumentacioni të jetë i plotë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pra, ishin disa arsye pse nuk na e dhanë të plotë. Por për gjashtë muaj, u bë një plan pune, ua çuam britanikëve dhe them se i kanë rregulluar të gjitha.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Lindita Nikolla – Sepse në Shqipëri nuk ishte asnjë universitet publik i akredituar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Edhe pse te ligji i vjetër...

Milva Ekonomi – Ishte kërkesë.

Lindita Nikolla – Ishte kërkesë për akreditimin institucional, se programet janë...

Agron Cuka – Akreditimin institucional e kemi për tre vjet.

Lindita Nikolla – E di, e di.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mirlinda Galushi – Në fakt, ky bëri mirë, sepse në pjesën financiare kishte gjithmonë kontrollë. Nuk dua të bëj oponentë, por u trondit paksa pjesa administrative dhe ajo mësimore në pjesën e donacionit. Me një fjalë, problemi tani është që të dyja anët e dinë se si do të funksionojnë të dyja krahët.

Lidhur me dokumentacionin e përgatitur në atë kohë, u desh që të angazhohej i gjithë stafi, edhe ai akademik, edhe ai administrativ. Kështu u mësuan shumë gjëra në pjesën e akreditimit për të dyja proceset, si në procesin e pjesës mësimore, ashtu edhe në pjesën administrative për vënien në dispozicion të dokumentacionit përkatës.

Mund të them se realisht ishte një eksperiencë për ne, se tani në fazën tjetër jemi të përgatitur, falë një bashkëpunimi të të dyja anëve, si pjesës mësimore dhe asaj administrative. Shpresojmë që tani jemi të përgatitur për ta dhënë dokumentacionin më mirë për fazën, vitin që vjen.

Robert Çitozi – Në vitin 2020 e kemi.

Milva Ekonomi – Po me universitetet simotra, me të cilat punoni, shikoni gjëra të ngjashme me tuajat?

Mirlinda Galushi – Po, madje disa programe studimi i kemi falë projekteve TEMPUS.

Agron Cuka – Ne kemi pasur tri projekte TEMPUS me bashkëpunëtorët tanë nga Austria, Italia, Danimarka, Greqia dhe programet tona janë të regjistruara në Europë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Janë realizuar konform kërkesave të tyre. Në këtë pikë ne mund të themi se jemi në rrugë të mbarë, kemi ecur përpara.

Lindita Nikolla – Keni pasur shkëmbime?

Robert Çitozi – Po. Dy studentë tanë janë në Rumani për momentin.

Agron Cuka – Kemi çuar studentë në Itali, në Bosnjë, dy janë tani në Rumani, si dhe kanë ardhur këtu pedagogë nga Rumania e kështu me radhë.

Juel Rajani – Por do të shkojnë edhe dy pedagogë tanët për dy javë.

Agron Cuka – Në Rumani.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Juel Rajani – Nëpërmjet programit “Erasmus+”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Aktualisht po ndërtojmë edhe Qendrën e Karrierës për të trajnuar mësuesit me një projekt të përbashkët me ministrinë. Jemi të gjitha universitetet publike dhe secili universitet po ndërton qendrën e tij të trajnimit të mësuesve. Ne e fillojmë pilotimin në maj me të parën.

Mirela Kumbaro – Sa studentë keni?

Agron Cuka – Afërsisht 1400.

Robert Çitozi – 1370 po themi, plus/minus.

Agron Cuka – Çdo vit pranojmë 155 studentë në njërin fakultet, rreth 160 në qoftë se ka edhe të ardhur nga trojet, 150 studentë tek i dyti...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Juel Rajani – Nëse hapet fakulteti i tretë, do të kemi një kuotë prej 75 studentësh.

Agron Cuka – Një gjë kemi: kur vjen puna për të na kontrolluar për kapacitetet, na i numërojnë karriget një më një.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Çfarë t’ju them?! Edhe sipërfaqet e banjave, auditorët një më një numërohen. Pastaj, nuk e di, ka një lloj tolerance te privati, që lë për të dëshiruar, se është edhe një konkurrencë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mirela Kumbaro – Sa universitete private ofrojnë paralelisht program të ngjashëm me tuajin?

Agron Cuka – Që përgatisin mësues të edukimit fizik ka një program shtetëror Elbasani.

Juel Jarani – Zonja Kumbaro pyeti për universitetet private.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mirela Kumbaro – S’ka problem, më thoni edhe për të tjerët.

Agron Cuka – Jua them që t’i dini të gjithë. Elbasani dhe Shkodra përgatisin mësues për edukimin fizik. Ndërkohë, universiteti “Marin Barleti” ka hapur programe para disa vitesh, ndërsa këtë vit ka hapur edhe Universiteti European i Tiranës. Me thënë të drejtën, tek universiteti “Marin Barleti” më ngec gozhda mua.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Me sa kam informacion, auditori më i madh që kanë është 90 vende, ndërkohë që numri i të pranuarve në vitin e parë, me aq sa kam dijeni, është 225.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mirela Kumbaro – Nuk ka sistem seleksionimi?

Lindita Nikolla – Këto duhen verifikuar, sepse është gjithmonë...

Agron Cuka – Ky është informacioni që unë kam.

Lindita Nikolla – Po, pra, se mund të dish kuotat, por privati nuk i ka kuotat e përmbushura as 40%. Duhet ta verifikojmë edhe ne, por nuk ma merr mendja të jenë aq.

Juel Jarani – Kam dhënë unë mësim atje.

Agron Cuka – Kanë qenë dhjetë pedagogë që u larguan.

Juel Jarani – Salla më e madhe ka 90 karrige, ndërkohë studentë ishin 182, flas për vitin kur kam qenë unë, dhe pastaj numri ka shkuar në 220.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Lindita Nikolla – Si kuota apo numër studentësh?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Juel Jarani – Për studentë në auditor flas.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të regjistruar flas.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në momentin që nuk pashë më shumë se 60 studentë, mbaj përgjegjësi për fjalët që them, ndërpreva marrëdhëniet me ata, sepse ndërkohë që këtu e shtrëngojmë studentin në maksimum, atje ishte e pamundur të mos shihja 120 veta gjithë vitin dhe në fund fare të vendosja notat. Kështu që, mendova që më mirë do t'i bëj hyzmetin aty ku u rrita, aty ku kalova nga student në pedagog, sepse ishte e pamundur që të lëvizja edhe moralisht në dy standarde, me diferencë shumë të madhe nga njëri-tjetri.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kjo nuk ka të bëjë fare, sepse kam punuar gjashtë vjet atje dhe përgjithësisht i jam mirënjohës çdo vendi ku kam punuar dhe ku kam përfituar diçka ligjërisht për familjen time dhe veten.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Por është një lloj ngërçi.

Ismet Beqiraj – Do të verifikojmë në arsimin parauniversitar...

Te klasat nga e gjashta tek e nënta, nga e dhjeta tek e njëmbëdhjeta, ka një vakum të madh të specialistëve, sidomos të mësuesve të përgatitjes fizike, saqë detyron, sidomos në zonat rurale, por edhe tek ato urbane, të kategorisë së dytë dhe të tretë, të emërohen mësues me kontratë provizore të formimit, jashtë këtij programi. Ju me të drejtë e thoni, por unë dua të pyes: duke pasur këtë etje, këtë kërkesë që e ka edhe arsimit parauniversitar, nuk ka mësues të përgatitjes fizike?..

Juel Jarani – Mësues ka, por nuk shkojnë atje ku duhet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fadil Nasufi – Sepse në shumë shkolla nuk plotësohet numri i orëve dhe reduktohen lëndët, si fizikultura dhe muzika, të cilat i merr mësuesi i kimisë apo i fizikës dhe jep edhe edukim fizik.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ke edhe në Berat, që në portal është në vendin e tretë, por nuk gjen vend pune si mësues fizikulture...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj – Në varësi të tipologjisë së zonave të ndryshme. Në zonat që përfaqësoj unë, e kemi këtë shqetësim. Kjo do të shkojë drejt kësaj, nëse themi që secilit t'i gjejmë, jo vendin e punës, por punës t'i gjejmë njeriun. Nëse ai do të konkurrojë në Universitetin e Sporteve...

Juel Jarani – Vijnë, ka shumë kërkesa.

Ismet Beqiraj - A i merrni në konsideratë kërkesat që janë sipas nevojave, duke bashkëpunuar me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, apo sipas takatit financiar, të buxhetuar nga shteti dhe nga të ardhurat nga tarifat?

Robert Çitozi – Po, i marrim në konsideratë. Pranimi është me konkurs.

Ismet Beqiraj – Na e sqaroni këtë!

Robert Çitozi – Ne çdo vit marrim statistikën nga Drejtoria Arsimore. Nga këta që u regjistruan në portal dhe e kaluan provimin, sa prej tyre janë futur në punë? Të them të drejtën, gati të gjithë janë futur në punë, sepse ka 3-4 vjet që janë shtuar orët e edukimit fizik dhe kërkesa ka pafund. Qarku i Vlorës dhe më sipër ka mungesa për mësues të edukimit fizik, sepse ata vijnë në Tiranë. Vetëm Jugu...

Ismet Beqiraj – Është qarku i Fierit, që është një qark i madh dhe unë nuk ta thashë kot këtë.

Agron Cuka – Unë e di se me këtë punë merrem. Vetëm Jugu, vetëm Departamenti i Universitetit të Elbasanit ka 60 veta të përmbushur, pra është shumë e pakët kërkesa që ofrohet prej qyteteve në krahasim me atë që prodhon Elbasani.

Në Veri prodhohen vetëm 60 kuota në vit nga Departamenti i Shkodrës.

Robert Çitozi – Ta sqarojmë pak këtë. Këto nuk merren të ndarë me zona Veri-Jug. Po t'i marrësh në total, e marrin diplomën si mësues të edukimit fizik rreth 200-250 veta në vit në të gjithë Shqipërinë nga 3 universitetet shtetërore, pa llogaritur shkollat private. Përveç këtyre, shkojnë edhe te UET-ja apo te “Marin Barleti” numra relativisht të lartë.

Ismet Beqiraj – Gjurmimi i mundësisë së punësimit të tyre, a është bërë?

Robert Çitozi – Mbi 75% janë të punësuar. Kjo është e garantuar.

Milva Ekonomi – Kam edhe një pyetje, duke iu referuar faktit kur në Ministrinë e Arsimit erdhi një zëvendësministër i caktuar për sportin, i quajtur Rauf, i cili punonte shumë me shëndetësinë, për ta bërë sportin pjesë të mirëqenies fizike, të shëndetit të popullatës. Nisur nga kjo gjë, që dukej sikur do të kishte një impakt për një shëndet më të mirë të popullatës, ju a inicioni gara pranverore, krosin pranveror? A i nxisni studentët të marrin pjesë në të tilla gara? Nuk e di se sa janë sportet, ku ka pjesëmarrje masive. A ndihmoni ju për këtë?

Agron Cuka – Ka një federatë...

Milva Ekonomi – Kam edhe një pyetje të dytë. Nisur nga kjo dhe duke pasur parasysh se shëndeti i popullatës është bërë i rëndësishëm, dhe te ne ka disa mjete që e transmetojnë informacionin, siç është telefoni dhe aplikacionet në celular, a ka bërë fakulteti juaj ndonjë përpjekje që këtë teknologji inovative ta vendosë nëpërmjet studentëve dhe pedagogëve në shërbim të popullatës, duke krijuar ndonjë aplikacion për ndonjë ushtrim të veçantë për edukimin fizik apo për diçka tjetër? Nuk e di se me çfarë tjetër mund të jetë.

Agron Cuka – Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Rekreacionit pikërisht me këtë merret. Ky është një fakultet, ku mbarojnë çdo vit 150 veta. Kemi një marrëveshje me Bashkinë e Tiranës dhe me shumë palestra, me njësi të ndryshme, që merren me aktivitet fizik. Pra, përveç përgatitjes së mësuesve, studentë dhe pedagogë tanët, kur bëjnë praktikat, dalin te Liqeni Artificial i Tiranës, ku mbledhin njerëz të ndryshëm.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Bëjnë një program pune, nxjerrin një shpallje për ta parë njerëzit që janë të interesuar të vijnë dhe zbatojnë atje shumë programe të ndryshme aerobike, joge, artesh marciale etj.. Këtu kanë shkuar edhe pedagogët, edhe studentët për të dhënë shembull.

Milva Ekonomi – Kjo është vetëm për Tiranën apo është e përhapur në të gjithë Shqipërinë?

Agron Cuka – Po kur bëjnë praktikë, këtu mund t'i çojmë, se nuk i çojmë dot në rrethe.

Juel Jarani – Studentët tanë kanë qenë në promovimin e Ulza Park, ku kemi bërë një aktivitet spektakolar në Liqenin e Shkopetit me kajakë, me biçikleta dhe me gjithçka tjetër.

Në një aktivitet për promovimin e kajakut në Liqenin Artificial të Tiranës kanë qenë studentët dhe pedagogët tanë, në bashkëpunim me APR-në dhe me Komitetin Olimpik. Kështu, përgjithësisht kemi qenë shumë aktivë.

Siç e tha edhe rektori, fakti që një nga diplomat tona më të rëndësishme është edhe ajo e trajnerit të fitnesit, jemi prezentë me ish-studentët tanë të diplomuar tashmë në fushën e fitnesit, në një dominancë të qendrave të fitnesit apo të pishinave.

Agron Cuka – Për sa i përket kësaj pike, për t'i dhënë rëndësi kësaj diplome, duke marrë shembull nga bota, kemi kërkuar që kjo diplomë të futet te profesionet e rregulluara me ligj. Rezultoi që kishte edhe disa profesione të tjera, që duhet të përfshiheshin këtu. Ministria po e trajton edhe këtë problem. Jemi në pritje të kalimit të procedurave, që duhet të kalojnë në qeveri.

Robert Çitozi – Për sa u përket aplikacioneve, ka aplikacione falas për prindërit...

Agron Cuka – Ta mbaroj këtë, se është shumë e rëndësishme të kuptohet se njerëzit që stërviten qoftë në palestra, qoftë individualisht te Liqeni apo në ambiente të tjera, e njohin shumë pak se çfarë ngarkese duhet të marrin; veçanërisht këta që shkojnë në palestra, janë njerëz që ndoshta nuk janë shkolluar për këtë dhe ti shkon e u beson shëndetin. Askush nuk e ndalon atë të punojë. Ai nuk di se çfarë bën. Unë kam rastisur në disa raste kur kam parë që i fuste moshat 50-60-vjeçare së bashku me vajzat e reja për të bërë aerobi me muzikë dhe asaj sa nuk po i plaste zemra. Unë ndërhyra dhe i thashë: “Avash, shikoje këtë!”

Pra, janë disa gjëra që nuk shkojnë, se në vend që ta rregullojë, ai e dëmton shëndetin. Pra, duhet patjetër një trajner i diplomuar, që ta varë diplomën në mur.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Juel Jarani – Trajner i fitnesit, që punon në palestra dhe merret me shëndetin e popullatës.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, patjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj – Bëhet ndryshimi në ligj, se unë jam marrë shumë me këto profesionet e rregulluara dhe është ligji bazë, siç është Urdhri i Mësuesit, për shembull, apo te profesionet e tjera të rregulluara.

Juel Jarani – Për të plotësuar atë që tha rektori, pse lindi edhe si kërkesë e studentëve, sepse studenti ynë mbaron 3 vjet për ciklin e parë, *bachelor* dhe 1 vit është masteri me 60 kredite, që bëjnë 240 kredite dhe kërkon të punësohet në qendrën e fitnesit, në pishina apo diku tjetër.

Askush nuk e ndalon një të ri, i cili ka bërë muskuj, ka eksperimentuar në trupin e vet, por nuk ka bërë asnjë ditë shkollë. Po të shohësh kurrikulën tone, ne kemi gati 30-32 lëndë mjekësore, duke filluar nga Anatomia, Fiziologjia, Fiziologjia e Aplikuar, Traumatologjia, Shëndeti Publik, Fizioterapi, Masazhi e të tjera, të cilat e plotësojnë figurën e këtij njeriu që do të merret me njerëzit. Dikur, para viteve '90, kemi thënë se njeriu është kapitali më i çmuar. Nuk e di se sa e drejtë është si fjalë.

Tani nuk e ndalon asnjëri këtë njeri pa shkollë që ta konkurrojë studentin tonë. Ai shkon në një universitet privat, që me të drejtën e ligjit hap një kurs 2-vjeçar, që u jep licencën e operatorëve të turizmit në fitnes, palestër dhe evente publike, dhe konkurron ai pa shkollë fare, ky tjetri me kurs 2-vjeçar dhe ky yni me cikël 4-vjeçar. Në momentin kur asnjë ligj nuk e rregullon këtë dhe nuk i jep përparësi këtij arsimimi të gjatë, unë, si prind, përse duhet ta sjell tim bir për të bërë 4 vjet shkollë, kur mund ta hapë vetë derën e palestrës? Ai ka bërë disa eksperimente në trupin e vet, ka bërë një trup të bukur dhe merr të drejtën të punojë me fëmijët e të tjerëve. Kjo nuk është e drejtë!

Prandaj, kemi kërkuar që, në radhë të parë, nga 28 vende, 19 vende t'ia marr unë, me materialin që i kemi çuar ministrisë. 19 vende të BE-së e kanë të përcaktuar emërtimin “Trajner i fitnesit” apo “Instruktur fitnesi” apo “Drejtues i qendrës së fitnesit”. Nuk ka rëndësi, por ne e kemi quajtur “Trajner i fitnesit”.

Debati që u bë në ministri, mbasi ndryshoi drejtimi i ministrisë, ishte se edhe brenda ministrisë nuk kishte një koncept të qartë se çfarë është bordi kompetitiv dhe se çfarë është aktiviteti fizik për shëndetin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Trajnerin e rregullon ligji “Për sportin”. Atë e bëjnë federatat, kualifikimet në bashkëpunim me institucionet. Padyshim, e bëjnë federatat.

Ne nuk po flasim për kompetecion, jo për thyerje të rekordit kombëtar apo të atij olimpiq, por po flasim për aktivitet fizik, për shëndet për të gjitha kategoritë e popullatës. Në

momentin që qartësohet kjo, edhe studenti ynë ka të drejtën t'i bëjë këto 4 vjet dhe të jetë serioz në tregun e punës, sepse seriozë kanë qenë ata njerëz që e kanë mbështetur këtë program studimi, sepse merret me njeriun.

Agron Cuka – Për aktivitetet me studentët ka një federatë studentore sportive, që bën lidhjen e të gjitha universiteteve. Mbi këtë bazë, kryhen çdo vit disa lloj aktivitetesh.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Tani kishte një aktivitet futbollit etj..

Ne bëjmë edhe aktivitetet tona brenda institucionit. Pothuajse të gjitha llojet e sporteve, në futboll, volejball, basketboll, tenis, ping-pong, gjimnastikë etj., kudo ku mund të aktivizohen studentët, ne i bëjmë. Pra, konkurrojnë brenda grupeve studentore dhe tani është periudha e pranverës, koha kur realizohen këto. Brenda pranverës mbyllen të gjitha aktivitetet.

Kemi oferta për të bërë aktivitete edhe me universitetet e tjera. Kemi pasur edhe me Kosovën dhe vendet që kemi pranë, por unë isha në Hungari javën e kaluar për të lidhur një marrëveshje me ta. Ata, një nga pikat më të rëndësishme, kishin aktivitetet sportive në kuadër të shkëmbimit të kulturave, të bëjmë aktivitete sportive 2-palëshe. Ne të çojmë një grup studentësh, ata të sjellin një grup studentësh. Ju sillni futbollin, ne sjellim basketbollin e kështu me radhë. Kështu jemi, në këto hapa.

Lindita Nikolla – Plus këtyre, ka një qendër shumë të mirë shkencore, që bën studime të thelluara dhe analiza për lidhjen mes shëndetit fizik dhe shëndetit në përgjithësi.

Robert Çitozi – Janë 2 departamentet që përmenda në fillim. Një departament merret me sportin cilësor dhe tjetri merret me...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ne kemi bërë një anketë për autometrinë për peshën, gjatësinë, perimetrin e belit për trojet shqiptare. Janë marrë gjithsej 18000 fëmijë nga të gjitha trojet shqiptare. Është bërë një studim për 5 vjet mbi obezitetin, me të gjitha normativat e obezitetit dhe të mbipeshës. Prindi mund ta shkarkojë falas aplikacionin, për të parë se ku renditet fëmija i vet me ato parametra që ka në trojet shqiptare. Patëm probleme, mërzi, sepse e morën si...

Milva Ekonomi – Pse, jemi obezë ne shqiptarët?

Robert Çitozi – Jo. Obeziteti është 5,1%, ndërsa mbipeshja është 10,2%.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në krahasim me shifrat 12 dhe 15% për obezitetin, që ka Italia dhe Greqia, ne jemi shumë mirë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të mos harrojmë që ka një problem metodologjik këtu. Të gjithë krahasohen me normativat amerikane. Këtu është gabimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Normativat amerikane, që janë shumë të larta. Ne kemi bërë normativat tona me këtë grup prej 18 mijë fëmijësh. E kemi bërë këtë, që fëmijët tanë të krahasohen me fëmijët tanë. Ky është rezultati real dhe del 5 presje ca përqind.

Milva Ekonomi – Mirë, na dhatë një panoramë të gjithë punës që bëni për jetën e brendshme tuajën. Po në pjesën që ka qenë pak më e përgjithshme, si për shembull, “Pakti për Universitetin”, si e keni parë veten ju?

Juel Jarani – Ne e kemi parë veten si zot shtëpie, duke ndenjur çdo ditë, të 90 pedagogët, në krye të detyrës, duke komunikuar me çdo student dhe këtu nuk ka ndodhur as të thyhet institucioni, as të pushtohet institucioni, sepse kemi qenë çdo ditë.

Zonja Milva, unë e mbyll makinën time në darkë kundrejt një pagese te Fakulteti i Shkencave të Natyrës. Aty unë nuk shikoja pedagogë, por shikoja me dhimbje se si poshtërohej institucioni. Ne nuk u kemi thënë mos shkoni në protestë, përkundrazi, nëse doni, mund të shkoni në protestë, por kush ka dëshirë të bëjë mësim, pedagogu është në auditor sipas orarit. Kjo krijoi konfuzion brenda tyre, por ama jo të gjithë do të jenë me një mendje për në protestë dhe jo të gjithë do të jenë në një mendje për në mësim, por pedagogët kanë qenë të gjithë në mësim.

Unë besoj se ky ka qenë çelësi i bashkëbisedimit. Ata kanë artikuluar mendimet e tyre në takime masive në sallën më të madhe që ne kemi, ashtu siç e kanë bërë edhe me zëvendësministrin e Sporteve para 2-3 javëve. Pra, ne i kemi dalë zot shtëpie institucionit dhe bashkë me studentët kemi pasur mirëkuptimin për të diskutuar për problemet që ata kanë, por jo me dhunë dhe jo duke shkatërruar institucionet.

Robert Çitozi – 60-vjetori qëlloi në kulmin e protestës.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Agron Cuka - Aktualisht ju kemi ndenjur shumë afër dhe këtë ata e kanë shprehur edhe në protestë.

Robert Çitozi – Kanë shkuar për t’u solidarizuar, sepse personalisht nuk kanë artikuluar ndonjë kërkesë.

Agron Cuka - Kërkesa direkt në drejtim të institucionit nuk ka pasur. Ndoshta ka ndihmuar situata që u krijua vjet, kur një grup studentësh të masterit bojkotuan mësimin për një X problem. U interesova dhe mora vesh që ishin studentë të masterit. Kur u ulëm në

tavolinë, çështja u sqarua dhe studentët ranë dakord. Nuk mund të protestosh pa shtruar njëherë problemin te drejtuesi i institucionit apo në ministri. Shtrohet problemi dhe nëse nuk zgjidhet, atëherë rruga e vetme ngelet protesta.

Mirlinda mori përsipër të sqaronte çështjen e tarifave dhe disa çështje të tjera, dhe pastaj u ra dakord. Ndoshta është favor që është shkollë e vogël, por për të thënë të drejtën edhe pedagogët kanë qenë në krye të detyrës. Çdo ditë pedagogët paraqiten në punë. Nuk ka pasur asnjë presion për të mos dalë në protestë. Madje, kur më kërkuan takim mua, dikush nga fundi tha: “ne nuk jemi ata të protestave”. Unë i thash që jam pro protestave, sepse kur i mbështet, gjen tjetër mirëkuptim.

Robert Çitozi - Kërkuan 40 minuta kohë t’i linim në sallën e madhe.

Agron Cuka – Ne, ndoshta, i kemi marrë shumë shpejt vendimet për përgjysmim të tarifave apo përjashtimet nga detyrimet, bursat ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mirlinda Galushi – Ne kemi 10 studentë ekselentë...

(nuk dëgjohet)

... i sqarua se nga detajimi i buxhetit nga të ardhurat, do të përmirësonim ato çfarë kërkonin ata. Në strukturat kolegjiale të universitetit u miratuam ato çfarë ata kishin të domosdoshme, duke riparë disa zëra. Mirëprita nga ata pyetjet dhe kërkesat që kanë për përgatitjen e projektbuxhetit.

Gjithsesi, kjo do të vazhdojë edhe me fakultetin tjetër dhe me ciklin e dytë të studimeve, por ky ishte një hap i parë. Ndoshta është mirë edhe për pjesën administrative.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të ngrenë të gjitha problematikat që kanë. Normalisht, na ndihmojnë edhe ne, si rektorat, për të paraqitur më mirë kërkesat në organet kolegjiale.

Milva Ekonomi – Po nga biblioteka online, përfitojnë studentët tuaj?

Mirlinda Galushi – Ne ishim në takimin që u organizua nga ministria, ku ishte prezent edhe Kryeministri. Të gjitha adresat e *e-mail*-it të studentëve janë në programin e RASH-it.

Robert Çitozi - Ka mbi 5 vjet që komunikojnë me RASH-in. Janë të informuar dhe e dinë ku mund të futen. Nuk po bëhet sistemi i ri,

Mirlinda Galushi – Për sa i përket tarifës së studimit, në momentin që u përgjysmua ... dhe disa prej tyreve u kishte shkuar gabim. Faturën e tarifës dhe gjithçka tjetër ata i printojnë nga sistemi.

Robert Çitozi - Aktualisht, siç kanë ardhur udhëzimet, në kuadër të “Paktit për Universitetin”, çdo gjë është e hapur, vendime të bordit të administrimit dhe gjithçka tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj – Si pjesë e trupës akademike të Fakultetit të Shkencave të Natyrës në Universitetin e Tiranës, edhe gjatë protestave unë kanë bërë mësim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mirlinda Galushi – Pjesa më e madhe e tyre, bënë mësim.

Juel Jarani - Për të mos thënë që një nga ata, shkoi të fyente pedagogët.

Ismet Beqiraj - Më vjen mirë që ju e keni menaxhuar në mënyrë perfekte protestën e studentëve. Universitetet e tjera patën probleme. Si mendoni, pse ka ndodhur kjo, nga eksperiencia juaj? Keni bashkëpunim me studentët, por edhe dy poet e qeverisjes të administrimit të universitetit, qoftë pjesa akademike, qoftë administrative dhe financiare. Ku çalon te Universiteti i Tiranës?

Agron Cuka – Unë nuk di shumë gjëra për ta. Ndoshta më tepër është një marrëdhënie personale e individëve.

Ismet Beqiraj – Statutin e Universitetit kur e keni miratuar, nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit?

Robert Çitozi - Vazhdon statuti i vitit 2013. Unë jam te Komisioni i statutit.

Juel Jarani – Kemi biseduar në ministri dhe presim që të bëhet fakulteti i tretë, ta vendosim në statut, të ndryshojmë edhe Rregulloren dhe gjëra të tjera.

Mund të jap një argument për profesorin?

Aktiviteti fizik që ne bashkë me studentët dhe trupën pedagogjike, me të gjitha vështirësitë dhe problematikat, bëjmë për dy javë në Voskopojë për sportet dimërore dhe dy javë në Jalë të gjitha sportet ujore, kontaktet dhe praktikatat që ne bëjmë jashtë shkolle, ndoshta e bëjnë më të afërt marrëdhënien pedagogë-studentë. Kur mungon komunikimi, besoj se krijohet një hendek midis studentëve dhe pedagogëve. Ndoshta është vetë specifika e shkollës që na e krijojnë këtë mundësi. Unë kam 1300 numra studentësh, të cilët e dinë që deri në orarin zyrtar të punës, përpara se të merrja detyrën e re këta 7 muaj, komunikoja me *e-mail* ose me mesazh për çdo problematikë, për sa kohë kam qenë i caktuar për komunikimin dhe marrëdhënien me studentët.

Kështu që, mendoj që kjo është arsyeja, që ne jemi në kontakt të vazhdueshëm me ta. Nuk e shikojnë pedagogun vetëm në auditor, por i njohin me emër dhe mbiemër. Është shkollë

me konkurrim, kështu që kontaktojnë me stafin e shkollës, përpara se të jenë studentë. Ndoshta kjo e bën komunikimin më të afërt edhe të mos kemi një mur mes njëri-tjetrit.

Ismet Beqiraj - Unë jam te Kimia Industriale dhe degët janë të shkencave ekzakte. Mua më shqetëson politizimi.

Lindita Nikolli- Universiteti i Tiranës është i vetmi universitet që e ka parasysh këtë.

Agron Cuka – Administratorja ka zbatuar teknikën: që të jesh trajner i mire, duhet të njohësh mirë lojtarët.

Kjo situata e dhjetorit, na ka gjetur me situatë ekonomike të shëndetshme.

Mirlinda Galushi -Në pjesën financiare gjërat kanë qenë gjithmonë transparente këtu në universitet. Në momentin që na janë kërkuar informacione për pjesën e buxhetit, i kemi dhënë informacionet. Kjo ka bërë që, duke pasur edhe mbështetjen maksimale të ministrisë, të gjitha të ardhurat t'i kalojmë në investime.

(Ndërrhyrje pa mikrofon.)

Almira Xhembulla – Profesor, në momentin që u njohët me dokumentin e “Paktit për Universitetin”, patjetër që filluat implementimin, por a e gjetët të arsyeshme që të adresonit ndonjë rekomandim?

Agron Cuka - Kemi pasur komunikime me ministrinë, erdhën ata të grupit, morën kontakt me ne, pas ca kohësh morëm kontakt edhe me studentët dhe u bë një takim shumë i madh.

Almira Xhembulla – Ngaqë jeni një nga modelet që nuk keni pasur probleme dhe keni funksionuar shumë mirë, mendoj se një rekomandim nga ju mund të ishte i mirë.

Agron Cuka -Ne kemi pasur problemet tona, për shembull, miratimi i diplomës për masterin dyvjeçar, të cilat i kemi në proces zgjidhjeje.

Marrëdhëniet me ministrinë kanë qenë të mira, ata përgatitën një draft, ne çuam sugjerimet tona për anën pedagogjike, financiare e të tjera dhe janë ndarë detyrat.

Milva Ekonomi- Sa i përket firmosjes së marrëveshjes për “Paktin”, a e keni firmosur atë?

Agron Cuka - Po do të firmosim sot, sepse kemi qenë jashtë shtetit dhe nuk kemi rakorduar.

Almira Xhembulla - Meqë thatë që dega e mësuesisë është ndër më të kërkuarat, a keni arritur që ta aplikoni kriterin e mesatares?

Agron Cuka - Po, nota mesatare është 6, por në praktikë kemi një konkurs të fortë dhe 70% e programit është praktikë sportive, pasi i kemi dhënë më shumë përparësi. Mesatarja

na ndihmoi të vinin shumë vetë dhe pastaj ne të përzgjedhim mes tyre me anë të konkursit. Deri tani themi që jemi mirë, por, nëse do të vijnë shumë konkurrentë, mund të rrisim mesataren në 7 dhe të kemi studentë më të formuar.

Ismet Beqiraj - A keni transferime nga universitetet e tjera, nga menaxhimi, për shembull ?

Robert Çitozi - Po i kemi, nga Menaxhimi dhe Juridiku kanë ardhur. Transferime paralele kemi më shumë, për shembull, nga universiteti “Marin Barleti”.

Fadil Nasufi – Së pari, dua t’ju falënderoj, sepse keni situatën më të mirë nga ato që kemi dëgjuar ne, si grup deputetësh, për problemet e universiteteve. E keni menaxhuar shumë mirë situatën dhe keni arritje. Në përgjithësi njerëzit e sportit janë shumë humanë, socialë dhe publikë. Një mësues fizikulture është, për shembull, më i dashuri i shkollës, po kështu edhe kampionët janë të dashur.

Cilat janë kërkesat tuaja për ne, si grup parlamentar, në lidhje me problemet që keni, për shembull, për terrenet sportive, statusin e pronësisë, çështjen e doktoraturave, plotësimin e vendeve vakante, çështjen e mësuesve të fitnesit e të tjera? Çfarë propozimesh të tjera keni që ne të ndërhyjmë në qeveri?

Agron Cuka - Statusi i veçantë na jep shumë lehtësira, sepse na ndihmon të japim grada dhe tituj shkencorë.

Bërja e fakultetit të tretë është një pikë tjetër.

Milva Ekonomi– Shqetësimi juaj është thënë dhe Kryeministri ka caktuar dy grupe të vogla pune për sportin dhe artin.

Agron Cuka – Na ka ardhur një shkresë para shumë kohësh, kur kemi diskutuar për ngarkesat e pedagogëve. Për shembull, ka dalë një urdhër i veçantë nga ju për ngarkesat e grupeve mësimore. Në universitetet e tjera grupet e seminareve shkojnë deri në 30 vetë, por praktika sportive nuk mund të bëhen me 30 vetë. Atëherë, na erdhi një miratim nga ministrja që grupet sportive t’i kemi me 18 vetë. Kjo ndryshon raportin pedagog - student.

Juel Jarani - Thuhet që duhet të ketë 18 doktor –profesor që të krijohet Këshilli i Profesorëve. Universiteti i Tiranës ka 850 pedagogë, ne jemi 90; është e pamundur që ne të kemi pastaj 18 doktor,profesorë. Kështu që te statusi besoj do të ketë fleksibilitet krijimi i kësaj mundësie.

Edhe një numër limit brenda ligjit duhet të ketë.

Ismet Beqiraj- Kur u hap programi i doktoraturave, ju u ankuat se nuk kishit trupë akademikë me grada dhe me tituj.

Agron Cuka -Ne nuk u ankuam, ne kemi pasur 17 doktor, profesorë dhe 12-13 profesorë të asociuar.

Deputet- Si ia bëni për udhëheqësit e doktoraturave?

Agron Cuka -Ne i kemi, por po na dalin në pension.

Juel Jarani - Nëse do të zhblllokohej sot situata, atëherë do të rregullohej, sepse, për shembull, ne jemi prej kohësh “profesor i asociuar” dhe do të mund të bëheshim “professor, doktor”.

Agron Cuka – Sa më shumë po vonohet procesi, aq më shumë po pakësohemi ne.

Ismet Beqiraj – Kjo nuk ju pengon ju.

Lindita Nikolli – Ka 4 vjet që nuk kanë marrë doktoratura.

Milva Ekonomi- Ju e ndoqët takimin që bëri Kryeministri për ndryshimet në Kodin Penal. A keni ndonjë mendim?

Agron Cuka – Jo, ne nuk kemi qenë, nuk kemi pasur ftesë.

Milva Ekonomi - E keni parë në lajme?

Agron Cuka -Patjetër që e kemi parë.

Milva Ekonomi– Pra, ka një nismë që vjen nga Kryeministri për dhunën e ushtruar në stadium. Në këtë moment Kryeministri ka sugjeruar që ne, deputetët e Kuvendit, të punojmë për disa ndryshime të Kodit Penal për ato raste, kur një individ kryen një vepër dhune ndaj një individi që ka një detyrë publike dhe, sidomos, kjo ide u nis nga ngjarjet e stadiumeve, pastaj të pacientit ndaj mjekut, deputetit, pra ndaj personit me detyrë publike. Cili është mendimi juaj për këtë?

Agron Cuka – Ne nuk kemi pasur probleme të tilla.

Kur ndodh, je i shqetësuar se si mund të zgjidhet. Në aspektin e dhunës, ne nuk kemi pasur.

Juel Jarani - Kryeministri tha të dënohet deri në 3 vjet. Mesa kemi informacion, Anglia e ka me 7 vjet, nëse ai hyn në fushë dhe dhunon, prandaj nuk ka më gardh dhe asgjë, sepse ai e di shumë mirë se po të shkelë në fushë dhe po të prekë personin në detyrë, dënohet me 7 vjet burg.

Milva Ekonomi – Faleminderit!

Agron Cuka - Po të shtrëngohen ligjet, vihet paqe, kur nuk ka bindje.

Ismet Beqiraj - Në kuadër të “Paktit” dhe partneritetit, si e gjykoni kompetencën e universiteteve për të penalizuar pedagogët që do të dalin me plagjiaturë? A është kjo ligjore

100% dhe e pastër? A mundet të arrijë universiteti deri në heqjen nga puna? Ne jemi në një debat të përditshëm me trupën pedagogjike jo nga frika.

Unë kam një qasje tjetër për këto vlerësimet e plagjiaturave. Cila është qasja? Sigurisht që ne e dimë që gjatë kësaj historie janë bërë dhe janë marrë tituj dhe grada shkencore edhe vetëm me një vendim të Presidentit, të Kryeministrit dhe të qeverisë, duke u nisur vetëm nga CV-ja e aktivitetit, udhëheqja për tema të ndryshme, që është bërë në universitete, udhëheqësit e diplomave, qoftë edhe për punime shkencore.

Lidhur me këto që ju thatë, varet se cilën quani ju plagjiaturë. Në konceptin tim kam rezerva për këtë punë, por teoria është teori dhe teorinë nuk e tjetërson dot, por je i detyruar ta citosh, ashtu sikurse e ka realizuar shkencëtari ose një studiues. Unë quaj plagjiaturë vetëm *copy-paste*-in e të dhënave, ndërsa po të lexosh midis rreshtave, është budallallëku më i madh.

(Diskutime pa mikrofon.)

Në momente të caktuara, nuk është fare përgjegjësia e iks-it që mban një gradë apo një titull shkencore, kur ai ka respektuar me fanatizëm kriteret dhe aktet nënligjore, por kjo nuk do të thotë që të tjerët të futen në këtë skaner...

Juel Jarani – Edhe doktoratura quhet shkollë. Pra, nëse im bir është për 4 dhe mësuesi i vë 10, faji i kujt është? Unë kam përshtypjen se faji është i mësueses. Pra, tani ky komision që më dha doktoraturën, duhet të më thoshte “Stop”...

Mirela Kumbaro – A mund t’ju them diçka, sepse kam 30 vjet karrierë akademike?

Juel Jarani– Unë kam 33 vjet.

Mirela Kumbaro – Në fakt, ajo që më shqetëson mua, gjë që doli edhe te debatet që u bënë, është se pritet të vijë një përgjigje nga qeveria. Qeveria merr përsipër të thotë se si mund të bëhen dhe kjo është bërë pjesë e debatit, ndërsa më pas hidhen në grykë dhe thonë: nuk e kam me ju, por jam duke folur...

Juel Jarani – Jemi duke folur për ato që kemi diskutuar gjatë takimit të fundit, pasi është kërkuar që këtë gjë ta bëjmë ne.

Mirela Kumbaro – Në fakt, nuk kemi pse ta shpikim ne votën. Kjo çështja se çfarë është plagjiaturë dhe deri kur konsiderohet e tillë, kush duhet të ndërhyjë, kur duhet të frenohet, duhet sqaruar, sepse e keqja ka shkuar shumë thellë, prandaj ka lindur ky shqetësim. Po ta kishin bërë këtë pyetje që në fillim të herës apo të erës, si ta doni ju, kur merremi me kërkim shkencor, nuk do të vinte puna deri te ky debat. Për mendimin tim, këtë diskutim duhet ta bëjë universiteti, sepse çështja e gjykimit, e parandalimit, e vlerësimit dhe e ndëshkimit të plagjiaturës është aspekt akademik. Kjo do të thotë që udhëheqësi i punimit, për shembull, unë

që udhëheq studentët që janë për doktoraturë, kur më vjen studenti dhe unë jam i pari si udhëheqës i atij studenti apo doktoranti, dhe kam përgjegjësinë e parë, sepse për këtë, unë nuk jam që ai të shkojë e të më sjellë mua 300 faqe dhe më pas unë t'i them firmose dhe shko te komisioni; komisioni më pas i thotë “prit se ky student i përveçse është nipi i filanit dhe i filanit, është edhe doktorant i Mirelës dhe tani si t'ia bëjmë ne me Mirelën?”, e më pas Mirela merr inat komisionin dhe hyn në konflikt, komisioni mbyll njërin sy dhe e kalon, e kështu me radhë. Ne nuk duhet të presim që ministri apo qeveria të prodhojë një ligj për këtë gjë, kjo frenohet aty...

(Diskutime pa mikrofon.)

Unë kam bërë një debat shumë të madh për këtë gjë 10 vjet më parë në fakultetin ku jam pjesë, por dilnin shumë pyetje që nuk mermin përgjigje. Çfarë do të thotë kjo? Pra, në qoftë se unë kap këtë doktorant dhe e ndëshkoj atë, udhëheqësin dhe komisionin, po gjithë ata të tjerët që i kanë vlerësuar persona të tjerë? Kësaj çështjeje ose do t'i futesh me themel, si Universiteti i Sporteve, Universiteti i Tiranë, Fakulteti i Shkencave e kështu me radhë, të bëhet një pastrim dhe atëherë do të pranojmë se do të heqim nga loja 50% të pedagogëve, nuk jam duke thënë më shumë, por për mendimin tim më shumë, sepse është e pamundur që ne të prodhojmë pa fund tituj, sepse është e pamundur që një profesor të udhëheqë 20 doktorantë, sepse është fizikisht e pamundur të lexosh 20 doktoratura dhe t'i verifikosh ato. E keqja ka shkuar shumë thellë, prandaj është shumë e vështirë të themi “nga sot e tutje”. Po këta të tjerët që ishin nga sot e dje, të cilët vazhdojnë punën, marrin tituj, vlerësojnë? Ne duhet t'i futemi një vlerësimi...

Unë mendoj se ka një zgjidhje, por nëse ne presim, siç jemi mësuar, se do të vijë...

Milva Ekonomi – Këtu ka nevojë për më shumë reflektim...

Mirela Kumbaro – Nuk qëndron problemi “është e ligjshme ose jo”, sepse legjitimiteti te bota akademike vjen në radhë nga integriteti i cilësisë së individëve, por edhe i institucionit, të gjitha ata që do të firmosin, sepse ky është një vullnet i brendshëm, i përbashkët. Por nëse Universiteti i Sporteve, meqë jemi sot këtu, do t'i hyj kësaj pune dhe do të ketë kurajën ta bëjë, mendoj se për këtë duhen ndjekur dy procese. E para, si do t'i hysh asaj që ke përpara? E dyta, si do të korrigjohet nga këtej e tutje?

Unë them që njëra nuk bën pa tjetrën, kështu që kjo kërkon një lloj reflektimi, duke menduar edhe pasojat, edhe procesin. Unë jam 100% dakord me kolegët e mi apo me Kryeministrin kur thonë që kjo gjë, në radhë të pare, duhet të vijë nga universiteti, sepse ankohe mi për plagjiatura dhe presim që të keqen ta heqë dikush tjetër, por legjitimitetin e keni

vetë ju, si pedagogë; këtu flas edhe për vete. Kemi bërë një *mea culpa* shumë të madhe, sidomos ne që flasim sot për plagjiaturë e kemi lënë atë të na kalojë para syve; kur kemi hapur gojën na është mbyllur goja ose e kemi anashkaluar dhe nuk jemi futur nëpër komisione. Pra, nëse e kemi pasur këtë zë, jemi anashkaluar nga vendimmarrja që do të kishte si detyrë vënien e gishtit në plagë.

Milva Ekonomi – Kjo nuk ka ardhur nga pedagogët, por nga pakënaqësia e studentëve për cilësinë e mësimdhënies. Ndërkohë duhet bërë një reflektim.....

Agron Cuka – Kjo gjë do të bëhet për institucionet publike apo edhe ato private, sepse në çdo takim me Kryeministrin kemi qenë vetëm ne që përfaqësojmë institucionet publike.

Mirela Kumbaro – Bota akademike nuk ka të bëjë me atë nëse është privat apo shtetëror, por me faktin nëse cilësia është e mirë apo e keqe.

Agron Cuka - Unë po ju them se nëpër takime kemi qenë vetëm ne që përfaqësojmë institucionet publike...

Robert Çitozi – Kjo është si puna e mesatares, në qoftë se mesatarja është 6, është si te publiku, edhe te privati...

Milva Ekonomi – Kjo gjë kërkon që ne prapë të kemi një bashkëbisedim vetëm për këtë temë...

Robert Çitozi – Kjo është temë e vështirë...

Milva Ekonomi – Kjo është një pyetje që secili prej nesh duhet t'ia bëjë në radhë...

(Diskutime pa mikrofon.)

Agron Cuka – Të dalë një komision mbi ato komisionet që kanë ndjekur gjithë procedurat dhe të thotë: “Shiko, ky e meriton e ky jo”. A do t'i marrim në konsideratë të gjithë ata që kanë qenë në këtë shkollë?

Milva Ekonomi – Ne nuk mund t'i japim zgjidhje tani. Pyetja që është bërë, duhet të na bëjë të gjithëve të reflektojmë, sepse ka shumë referenca në fushën ligjore, në atë të kadastrës, të industrisë, të naftës e të tjera me radhë...

Juel Jarani – Duhet një komision mbi komision dhe duhet parë se në çfarë periudhe duhet filluar...

(Diskutime pa mikrofon.)

Në qoftë se do t'i hiqet doktoratura dikujt që ka tituj, atëherë i bie që t'i hiqen edhe titujt? Do të largohet nga puna?

Një pedagog, i cili ka 30 vjet në këtë institucion, derisa ka marrë këta tituj...

(Diskutime pa mikrofon.)

A mund t'ju jap një shembull? Shkolla "Kristal", e pranishme këtu është edhe zonja Nikolla, e cila është marrë me mbylljen e këtyre fakulteteve të tmerrshme, ka dhënë diploma. U mbyll si shkollë, por diplomat vazhdojnë të jenë në treg...

(Diskutime pa mikrofon.)

Agron Cuka – Doktoratura ka qenë një shkollë. Tani ta marr përsëri studentin, meqë i kam dhënë një diplomë, edhe një herë në provim, se nuk i vlen diploma!...

(Diskutime pa mikrofon.)

Jemi edhe në vit electoral, kështu që të gjithë përballemi me këtë gjë...

Milva Ekonomi – Jo, kjo nuk ka lidhje fare...

Mirela Kumbaro – Ky është një debat që duhet bërë së brendshmi, duhet të shkruhen të gjithë skenarët dhe më pas të diskutohen, ju e shtroni për fushën tuaj, një tjetër për fushën vet...

Agron Cuka – Një formë seleksionimi është edhe kjo, doktorantët që kanë marrë doktoraturën duhet që brenda 5 vjetëve, siç e përcakton edhe ligji, të kenë kaç referime, të japin mësim jashtë vendit e të tjera me radhë dhe mendoj se kjo gjë i seleksionon...

Lindita Nikolla – Unë e kam nga eksperiencia kur u mbyllën universitetet private. Kur nisi verifikimi i kritereve të ligjit për universitetet, ne nuk e dinim se ku do të shkonim, të jem e singertë. Po çfarë bëmë? Ne pamë gjithë situatën në të gjitha universitetet, ndërsa tani jemi thjesht me hamendësime, dhe më në fund vendosëm. Pra, duke parë tipologjinë e shkeljeve për çdo kriter, vendosëm, sepse çdo universitet kishte problemet e veta, për të vetmen arsye se nuk kishte funksionuar monitorimi dhe kontrolli. Edhe ju duhet të ngrini një grup pune që të merret me këtë punë, sepse vendosja e vijës së kuqe duhet të bëhet në rang kombëtar, por ajo që duhet të fillojë sa më parë, janë kriteret e pranimit në doktoraturë.

Pra, nëse ti ke pasur si kriter notën mesatare, kanë qenë kaç kuota, ke pasur kaç profesorë, siç i ka të përcaktuara universiteti, jam e bindur se keni me dhjetëra në mos më shumë, sepse i kam parë vetë. Ne kemi bërë një kontroll, në qoftë se ju e mbani mend, në të gjitha universitetet dhe kemi parë se ka pasur shkelje. Unë mendoj se ju duhet të shihni në fillim situatën se deri ku shkon shkelja në rang kombëtar dhe, më pas, të vendosni nëse duhet hequr kjo apo jo, duke parë edhe masën e shkeljes.

Agron Cuka – Ne e kemi bërë procesin e skanimit për të gjitha doktoraturat, i cili është drejt përfundimit...

(Diskutime pa mikrofon)

Robert Çitozi – Problemi qëndron në faktin se disa prej doktoraturave kanë materiale, referime ruse, të cilave u janë referuar. Ku ta gjejmë ne *software*-in...?

Agron Cuka – Nuk duhet të hyjmë në detaje dhe ato që u thane, janë të drejta, prandaj ne duhet të ngremë një grup pune dhe të shohim gjërat e përgjithshme.

Milva Ekonomi – Unë mendoj se duhen parë të gjitha hapësirat që janë brenda kornizës ligjore dhe nëse ndonjë prej tyre del jashtë kësaj kornize, nuk funksionon. Këtë këshillë e kam nga disa juristë në kohën kur kam pasur një punë mjaft të vështirë, sepse të drejtosh një ministri është goxha punë e vështirë. Juristët të thonë bëj këndin e drejtë dhe nëse e ke bërë me logjikë është e saktë, ndërsa po doli nga korniza asnjëgjë nuk mund të funksionojë.

Falënderoj të gjithë profesorët që ishin të pranishëm!

(Diskutime pa mikrofon)

Sekretari i grupit është brenda familjes dhe vetëm ka dëgjuar.

Shumë faleminderit të gjithëve për pjesëmarrjen tuaj!